



DHOMA E TREGTISË DHE INDUSTRIË KOSOVË
CHAMBER OF TRADE AND INDUSTRY KOSOVA

26.07.2023
Prishtinë

Dhoma e Tregtisë zhvilloi takim me Kryeinspektorin e Inspektoratit të Punës

Vlerësimi i riskut në vendin e punës, mundësitë e zhvillimit të biznesit në vend, përmirësimi i kushteve në vendin e punës si dhe ikja e punëtorëve jashtë vendit ishin disa nga çështjet që u ngritën në takimin e përfaqësueseve të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë me Kryeinspektorin e Inspektoratit të Punës Hekuran Nikçi.

Përfaqësueset e Dhomës së Tregtisë u shprehën të hapura për bashkëpunim profesional me Inspektoratin e Punës me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe inputeve drejtpërdrejt nga bizneset, në mënyrë që të tejkalohen sfidat që hasin operatorët ekonomik gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Drejtoresha e Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë Kosovë Zana Beqiri, theksoi se me kërkesën e bizneseve DHTIK ka në fokus ngritjen e vetëdijes për respektimin e ligjit respektivisht rregulloreve të punës nga ana e bizneseve dhe punëtorëve.

Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës Hekuran Nikçi theksoi se është i gatshëm për bashkëpunim me Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë, ku i njëjti rekomandon mbajtjen e trajnimeve me qëllim të këshillimit të bizneseve si punëdhënës dhe punëmarrësve rreth përgjegjësive dhe respektimit të të drejtave në vendin e punës.

Si Dhomë e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë besojmë me vendosmëri se Qeveria e Kosovës në bashkëpunim me donatorët ndërkombëtarë duhet të i kushtojnë më shumë vëmendje përmirësimit të kushteve të punës në vend. Kjo konsiderojmë mund të realizohet përmes masave të ndryshme

Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Kosovë, Adresa: Rr. Bulevardi Bill Clinton, Hyrja 270, nr.6, 10 000 Prishtinë

Tel: [+383 38 223 212](tel:+38338223212), [+383 45 200 973](tel:+38345200973), E-mail: dhtikosove1@gmail.com;

www.odaefarizmit.org; www.dhtik.org

siç janë përmirësimi i mekanizmave kontrollues, rritja e personelit në inspektoratin e punës, certifikimi i trajnuesve profesionistë të punësimit etj.

DHTIK konsideron se krahas projekteve për përmirësimin e cilësisë së produkteve që ndihmon në rritjen e tregut, të rinjët kosovarë duhet që gjithashtu të ndryshojnë perceptimin e mjedisit të punës në vend, në mënyrë që të zvoglojmë numrin e të rinjëve që lëshojnë vendin në kërkim të një mjedisi që ofron mirëqenie dhe respektim më të madh të ligjit.